



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. -060/01-2206 dt. 14/01 2020

Procesverbal i Tubimit me Publikun

Mbledhjen e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dibra duke filluar në ora 11:00 më 24.12.2019, ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale, administrator të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, përfaqësues të OSBE-së, dhe përfaqësues të lagjeve dhe shumë qytetarë.



Rend dite: Raporti i të arriturave dhe sfidave gjatë vitit 2019

Bekim Dobra - Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin pas përfundimit të gjashtëmujorit të parë, të vitit fiskal dhe tjetri në fundvit, këtë që sot po e mbajmë. Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë njoftimin dhe ka publikuar dy javë para në ueb faqe të Komunës, në rrjetin social të Komunës, njoftimi është vendosur edhe në dy hyrjet e objektit të Komunës, është vendosur edhe në vendet me të frekuentuara si dhe në mediat online. Po ashtu janë kontaktuar të gjithë administratorët e fshatrave.

Ndjej për obligim të ju njoftoj për rregullat e takimit! Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës njoftojnë për aktivitetet e Komunës gjatë këtij viti, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet si dhe investimet kapitale, ndërsa ju të pranishëm, mund të shtroni pyetje dhe të jepni propozime e sugjerime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit dhe çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Ftojë Kryetarin e Komunës, z. Ramiz Lladrovci të përshëndet takimin.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- Falënderoj të gjithë qytetarët të cilët iu përgjigjen ftesës tonë për të identifikuar lëshimet në projektet që realizohen në komunën e Drenasit. Uroj që edhe në vitin 2020, të kontribuoni edhe denonconi çdo lëshim gjatë kryerjes së punëve, duke denoncuar me fakte. Të gjitha projektet e parapara të kryhen gjatë vitit 2019 edhe shumë projektet të bashkë financuara me nivelin qendror, kanë përfunduar sipas planifikimit. Komuna e Drenasit e ka pas buxhetin fillestar prej 15.171.602 euro, por për shkak të performancës së mirë dhe transparencës, këtë buxhet kemi shtuar nga grandet të ndryshme të performancës së mirë prej rreth 7% që i bie se tani e kemi rrit buxhetin prej 16.177.231.87 euro e këto grande i kemi fituar dhjetëra grante të ndryshme.

Për pjesën buxhetore, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, ftoj Drejtorin për Buxhet e Financa, z. Shyqiri Bublaku.

Për të elaboruar aktivitetet e Komunës gjatë këtij viti, për sukseset dhe sfidat, ftoj të autorizuarën në drejtorin për Infrastrukturë Lokale, znj. Flutura Avdiu

Drejtor i Financave Shyqiri Bublaku- RAPORTI I BUXHETIT PËR VITIN 2019

Duke u bazuar në buxhetin e certifikuar dhe aprovuar për vitin 2019 ku vlera e buxhetit të aprovuar për paga 8,423,505.00 € për mallra dhe shërbime shuma prej 1,716,041.00 € për shpenzime komunale shuma prej: 189,113.00 € Subvencione dhe Transfere shuma

prej:231,347.00 € dhe për investime kapitale shuma prej:4,611,596.00 € ku totali i buxhetit të aprovuar për vitin 2019 arrin shumën prej :15,171,602.00 € .

Por nëse e shikojmë buxhetin fillestar dhe e analizojmë me buxhetin përfundimtar do shohim se buxheti përfundimtar është më i madh se ai fillestar për :968,516.12 € . Duke analizuar dhe zhvillimin e buxhetit për periudhën janar – dhjetor (24.12.2019 ora 9.00).do të shohim në tabelën e më poshtme:

Kategoritë ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Përqindja	Buxheti fillestar
Paga dhe Mëditje	8,423,505.00	7,461,615.41	88.58	8,423,505.00
Mallra dhe Shërbime	1,619,662.09	1,417,157.73	87.50	1,716,041.00
Shpenz. Komunale	189,114.41	187,443.28	99.12	189,113.00
Subvencione dhe Trans.	255,201.56	245,978.88	96.39	231,113.00
Sh. Kapitale	5,652,635.06	4,388,793.68	77.64	4,611,596.00
Totali	16,140,118.12	13,694,200.98	84.92	15,171,602.00

Por duke analizuar që dhe pagat e Dhjetorit nuk janë bërë shpenzim (683,263.01) dhe shpenzime për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale përqindja e shpenzimit të buxhetit do të jetë shumë ma e lartë se kjo e paraqitur në tabelë. Dihet se në buxhetin fillestar kemi planifikuar të hyra vetanake në shumë 1,313,535.00 euro të cilat kanë qenë pjesë e buxhetit fillestar, ndërsa gjendja e të hyrave e realizuar sipas zyrtarit të të hyrave për vitin 2019 ka arrit shumën prej:1,695,382.47 €, pra siç shihet kemi tejkalim të hyrave në shumë prej:381,747.47 €

E autorizuar në Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale Flutura Avdiu- Gjatë vitit 2019 në Drejtorinë për Infrastrukturë Publike, në bazë të legjislacionit në fuqi, detyrave dhe kompetencave të Drejtorisë, sipas Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008 të Komunës së Glllogocit dhe planit të punës për vitin 2019, me qëllim të arritjes së objektivave janë kryer punët/aktivitetet të listuar si në vijim:

- RREGULLIMI I SHTRATIT TE LUMIT DRENICA DHE VËRBICA
- NDËRTIMI I KOLEKTORËVE PËR GRUMBULLIMIN E UJËRAVE TE ZEZA
- RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS. TROTUAR, NDRIÇIM PUBLIK- DRENASIT
- NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS DRENAS I,II,III DHE IV
- INFRASTRUKTURA NE KOMORAN I,II,III DHE IV
- NDËRTIMI I URAVE DHE TUMBINAVE
- ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN GLLANASELLË GODANC
- ASFALTIMI I RRUGËS TËRSTENIK I DHE II
- ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN POKLEK I VJETER, I RI, VASILEVË
- INFRASTRUKTURA NE FSHATIN ABRI E EPËRME, TËRDEVC
- ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN DOBROSHEC, ÇIKATOVE E VJETER

- ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN BAICË, KRAJKOVË, DAMANEK
- NDËRTIMI INFRASTRUKTURËS NE FSHATIN NEKOC, KISHNAREKE
- ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN GRADICË DHE LIKOSHAN
- ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN ARLLAT, NEGROC, GJERGJICË, BYTYQ
- ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN SANKOC DHE FUSHTICË
- ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN TËRDEVC - VUÇAK
- ASFALTIMI I RRUGËS SHTUTICË VËRBOC DHE POLLUZHË
- ASFALTIMI I RRUGËS FSHATIN LLAPUSHNIK POTERK-VUKOV
- ASFALTIMI NE FSHATIN ZABEL I ULET DHE EPËRM, KORROTICË E ULET-EPËRME
- NDËRTIMI I KAPACITETIT TE UJËSJELLËSIT NE DRENAS
- RREGULLIMI I VEND-NDALJEVE DHE MBULIMI I TYRE
- HAPJA E KANALEVE KULLUESE PËR GJATE RRUGËVE NE KOMUNE
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA DHE ATMOSFERIKE DRENASIN 1,2,3,4
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA KOMORAN I,II,III DHE IV
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA ARLLAT, NEGROVC DHE GJERGJICË
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA SANKOC FUSHTICË EPËRME DHE ULET
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA TËRSTENIK I DHE II
- KANALIZIMI UJERAVE TE ZEZA KORROTICË E ULET ,EPËRME POKLEK
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA DOBROSHEC ÇIKATOVË E VJETER
- KANALIZIMI UJERAVE TE ZEZA NE FSHATIN ABRI EPËRME, TËRDEVC
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA NE FSHATIN GLLANASELLË DHE GODANC
- KANALIZIMI I UJËRAVE TE ZEZA NE FSHATIN GRADICË, LIKOSHAN
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA-FSHAT. LLAPUSHNIK, POTËRK, VUKOV
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA NE FSHATIN NEKOC, KISHNAREKË
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA NE FSHATIN SHTUTICË, VËRBOC
- KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA BAICË, KRAJKOVË, DAMANEK
- NDËRTIMI I KOLEKTORËVE PËR GRUMBULLIMIN E UJËRAVE TE ZEZA
- ASFALTIMI NE FSHATIN ZABEL I ULET DHE EPËRM, KORROTICË E ULET-EPËRME

Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht kur të merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit për t'i adresuar kërkesat, apo sugjerimet tuaja.

Amrush Cakaj nga Komorani – ka pyetur për projektin e lumit Drenica dhe gjerësinë e tij pasi që është rregulluar afër 40 kilometra dhe ka pyetur gjerësinë e tij.

Përgjigje ka marr nga kryetari Lladrovci se gjerësia e lumit është e planifikuar sipas projektit të realizuar.

Sali Janova – nga Korrotica e Lartë – ka përgëzuar Komunën e Drenasit për projektet e realizuara gjatë këtij viti dhe ka thënë se fshati Korroticë e Ulët ka nevojë edhe për rrjet të ujësjellësit që të jetë në funksion dhe për një mbikallim të Kroni i Mbretit.

Kadri Ajazi – nga fshati Sankoc – ka falënderuar Komunën për projektet e realizuara në fshatin Sankoc dhe ka thënë se kanë mbetur edhe 200 metra në një lagje të fshatit pa rrjet të kanalizimit. Besim Tahiraj nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale ka thënë se kanalizimi në gjatësi prej 200 metrave është planifikuar për vitin e ardhshëm.

Halit Bytyqi nga Arllati – ka thënë se fshati ka nevojë për rrethojën e varrezave, në shkollë është investuar për ngrohje, por ka nevojë edhe për renovim. Ai ka thënë se kërkesat e fshatit janë për rrjet të kanalizimit për ujërat e zeza, sepse janë edhe disa lagje që nuk janë përfshirë ende në kanalizim e po ashtu disa lagje kanë nevojë edhe për asfaltim të rrugëve e po ashtu edhe rrjeti i ujësjellësit të behët funksional.

_____ Berisha nga Vasilevë – në fshatin Vasilevë këtë vit nuk është kryer ndonjë punë sidomos në asfaltim të rrugëve në disa lagje ndaj fshati ka nevojë për asfaltim në disa lagje e po ashtu edhe rrjeti i kanalizimit.

Fadil Tiku nga Vërboci – për punën që është bërë në fshatin tonë në vitin 2019 jemi mirënjohës, sepse të gjitha punët janë kryer si duhet, si asfaltimi në lagje, rrjeti i kanalizimit dhe rrethoja e shkollës, por kemi nevojë edhe për disa metra asfaltim të një rruge në lagjen Krelani dhe në disa lagje të tjera.

Imri Bajraktari nga fshati Kizharekë – në fshatin tonë vetëm një urë është kryer dhe më nuk është punuar asgjë gjatë këtij viti, ndërsa fshati nuk është përfshirë ende në asfaltim të rrugëve dhe janë në gjendje shumë të keqe, po ashtu ka nevojë edhe për rrjetin e kanalizimit në disa lagje. Besim Tahiraj nga Drejtoria e Infrastrukturës Publike i ka kthyer përgjigje se këtë vit është punuar edhe në asfaltimin e rrugëve në disa lagje të këtij fshati, ndërsa vitin tjetër do të vazhdohet edhe në lagje të tjera si në rrjetin e kanalizimit ashtu edhe në asfaltim të rrugëve në ato lagje që ende nuk është përfunduar.

Xhemajl Bytyqi nga Krajkova – gjatë këtij vit 200 metra asfalt janë shtruar në lagjen tonë dhe më nuk është punuar. Fshati ka nevojë shumë të madhe për ujë të pijshëm, janë gypat por ujë nuk ka, prandaj duhet të bëjë ndonjë investim komuna që fshati të këtë ujë. Po ashtu janë edhe disa lagje që nuk kanë rrjet të kanalizimit. Bytyqi ka pyetur edhe për rregullimin me zhavorr të rrugëve të rendit të katërt.

Besim Tahiraj i ka kthyer përgjigje dhe ka treguar për projektet që janë kryer gjatë këtij viti në fshatin Krajkovë dhe për projektet e planifikuara për vitin e ardhshëm.

Lumnije Krapë, drejtoresh e Shërbimeve Publike ka treguar për rregullimin e rrugëve në secilën lagje që është kryer me zhavorr të rendit të katërt.

Samedin Kiqina nga fshati Baicë – ka kritikuar për punimet që janë kryer dhe që po kryhen, ai ka vlerësuar sipas tij që punimet që janë kryer në fshatin Baicë nuk kanë qenë në nivelin e duhur, sidomos është fokusuar në rrethojën e shkollës.

Hysni Gashi nga fshati Llapushnik – ka thënë se në lagjen Tahiraj të këtij fshati ka mbetur një deponi pa u larguar dhe ka kërkuar që të largohet ajo deponi e mbeturinave e po ashtu ka thënë se në disa lagje të fshatit pak është investuar.

Arben Nika nga Drenasi – ka thënë se investimet në qendër të qytetit janë bërë shumë pak dhe qendra ka nevojë për kushtim me të madh pasi që shumica e projekteve në fshatra tanimë janë kryer dhe ka thënë se Drenasi ka nevojë për ndriçim të rrugëve të lagjeve, trotuare, parkingje me të mëdha, rregullimi i disa rrugëve me kubëza dhe projekte të tjera që do rregullonin qendrën.

Bekim Dobra- ka mbyllur takimin duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrje në këtë takim.

Takimi përfundoi rreth orës: 12:20min



Procesmbajtësi:

Shoq

Arben Shala